

# **LENGARICA & ENERGY SHPK**

**Pasqyrat Financiare  
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018**

**(me raportin e Audituesve të pavarur)**

# Përmbajtja

	<u>Faqe</u>
Raporti i Audituesve të pavarur	i-iii
Pasqyra e pozicionit financiar	1-2
Pasqyra e performancës financiare	3
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	4
Pasqyra e flukseve monetare	5
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	6
Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare	7-20



KPMG Albania Shpk  
Blvd "Dëshmorët e Kombit"  
Kullat Binjake Kulla 1, Kati 13  
Tiranë, Shqipëri  
+355(4)2274 524  
al-office@kpmg.com  
kpmg.com/al

## Raporti i Audituesve të Pavarur

Për ortakët dhe drejtimin e

Lengarica & Energy Shpk

### *Opinionit*

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Lengarica & Energy Shpk ("Shoqëria") siç paraqiten në faqet 1 deri 20, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018, pasqyrat e performancës financiare dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, ndryshimeve në kapital dhe flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2018, të performancës së saj financiare dhe flukseve të saj të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

### *Baza për Opinionin*

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri (Kodi i IEKA), si dhe me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar", të ndryshuar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK dhe Kodin e IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.



### *Çështje të tjera*

Pasqyrat financiare të Shoqërisë më dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017, janë audituar nga një auditues tjetër që ka shprehur një opinion të pa modifikuar mbi ato pasqyra më 30 mars 2018.

### *Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.



- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Fatos Beqja  
Auditues Ligjor

KPMG Albania Shpk  
Blvd "Dëshmorët e Kombit"  
Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 13  
Tiranë, Shqipëri

Tiranë, 12 nëntor 2019

**Lengarica & Energy Shpk**  
**Pasqyra e Pozicionit Financiar**  
(shumat në Lek)



Nr	Aktivitet	Shenime	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017 (Riparaqitur)
	<b>Aktivitet fatshkurtra</b>			
	▶ <b>Aktivitet monetare</b>	4	<b>19,941,516</b>	<b>144,063,845</b>
1	Banka		19,780,205	144,009,462
2	Arka		161,311	54,383
	▶ <b>Investime</b>		-	-
1	Në tituj pronësie të njësisve ekonomike brenda grupit		-	-
2	Aksionet e veta		-	-
3	Të tjera financiare		-	-
	▶ <b>Të drejta të arkëtueshme</b>	5	<b>291,352,443</b>	<b>152,497,485</b>
1	Nga aktiviteti i shfrytëzimit		-	10,111,987
2	Nga njësitë ekonomike brenda grupit		-	-
3	Nga njësitë ku ka interesa pjesëmarrëse		-	-
4	Të tjera		291,352,443	142,385,498
5	Kapital i nënshkruar i papaguar		-	-
	▶ <b>Inventarët</b>		-	-
1	Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme		-	-
2	Prodhime në proces dhe produkte gjysëm të përfunduara		-	-
3	Produkte të gatshme		-	-
4	Mallra		-	-
5	Aktive biologjike		-	-
6	AAGJM të mbajtura për shitje		-	-
7	Parapagime për inventar		-	-
	▶ <b>Shpenzime të shtyra</b>		-	-
	▶ <b>Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara</b>		-	-
<b>I</b>	<b>Totali aktiveve afashkurtra</b>		<b>311,293,959</b>	<b>296,561,330</b>
	<b>Aktivitet afatgjata</b>		-	-
	▶ <b>Aktivitet financiare</b>		-	-
1	Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit		-	-
2	Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit		-	-
3	Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		-	-
4	Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		-	-
5	Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata		-	-
6	Tituj të tjerë të huadhënies		-	-
	▶ <b>Aktivitet materiale</b>	6	<b>1,129,660</b>	<b>1,631,242</b>
1	Toka dhe ndërtesa		-	-
2	Impiante dhe makineri		-	-
3	Të tjera instalime dhe pajisje		1,129,660	1,631,242
4	Parapagime për aktive materiale dhe punë në proces		-	-
	▶ <b>Aktivitet biologjike</b>		-	-
	▶ <b>Aktivitet jo materiale</b>	7	<b>2,665,619,026</b>	<b>2,737,271,069</b>
1	Koncesione, patenta, liçenca, marka tregtare, të drejta dhe aktive të ngjashme		2,665,619,026	2,737,271,069
2	Emri i Mirë		-	-
3	Parapagime për AAJM		-	-
	▶ <b>Aktive tatimore të shtyra</b>		-	-
	▶ <b>Kapital i nënshkruar i papaguar</b>		-	-
<b>II</b>	<b>Totali aktiveve afatgjata</b>		<b>2,666,748,686</b>	<b>2,738,902,311</b>
	<b>Aktive totale</b>		<b>2,978,042,645</b>	<b>3,035,463,641</b>

**Lengarica & Energy Shpk**  
**Pasqyra e Pozicionit Financiar (vazhdim)**  
 (shumat në Lek)

Nr	Detyrimet dhe kapitali	Shenime	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017 (Riparaqitur)
	<b>► Detyrime afatshkurtra:</b>		<b>266,041,569</b>	<b>59,489,494</b>
1	Titujt e huamarrjes	12	81,917,861	14,785,702
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë		-	-
3	Arkëtime në avancë nga klientët		-	-
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	8	58,473,315	18,177,586
5	Dëftesa të pagueshme		-	-
6	Të pagueshme ndaj njërive ekonomike brenda grupit	8	50,964,108	26,053,413
7	Të pagueshme ndaj njërive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		-	-
8	Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore	9	142,567	431,916
9	Të pagueshme për detyrimet tatimore	9	491,718	40,877
10	Të tjera të pagueshme	10	74,052,000	-
	<b>► Të pagueshme për shpenzime të konstatuara</b>	12	<b>203,036,364</b>	<b>193,839,739</b>
	<b>► Të ardhura të shtyra</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
	<b>► Provizione</b>	11	<b>78,550,515</b>	<b>-</b>
<b>I</b>	<b>Totali i Detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>547,628,448</b>	<b>253,329,233</b>
	<b>► Detyrime afatgjata</b>		<b>1,987,439,360</b>	<b>2,536,305,822</b>
1	Titujt e huamarrjes	12	1,305,773,367	1,635,285,000
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë		-	-
3	Arkëtimet në avancë nga klientët		-	-
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit		-	-
5	Dëftesa të pagueshme		-	-
6	Të pagueshme ndaj njërive ekonomike brenda grupit	12,19	681,665,993	901,020,822
7	Të pagueshme ndaj njërive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		-	-
8	Të tjera të pagueshme		-	-
	<b>► Të pagueshme për shpenzime të konstatuara</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
	<b>► Të ardhura të shtyra</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
	<b>► Provizione</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
1	Provizione për pensionet		-	-
2	Provizione të tjera		-	-
	<b>► Detyrime tatimore të shtyra</b>	18	<b>17,073,404</b>	<b>12,307,969</b>
<b>II</b>	<b>Totali i Detyrimeve afatgjata</b>		<b>2,004,512,764</b>	<b>2,548,613,791</b>
	<b>Detyrime totale</b>		<b>2,552,141,211</b>	<b>2,801,943,024</b>
	<b>► Kapitali dhe Rezervat</b>			
	<b>► Kapitali i Nënshkruar</b>		<b>856,000,000</b>	<b>733,000,000</b>
	<b>► Primi i lidhur me kapitalin</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
	<b>► Rezerva rivlerësimi</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
	<b>► Rezerva të tjera</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
1	Rezerva ligjore		-	-
2	Rezerva statutore		-	-
3	Rezerva të tjera		-	-
	<b>► Fitimi i pashpërndarë</b>		<b>(499,479,383)</b>	<b>(296,052,515)</b>
	<b>► Fitimi/(humbja) e vitit</b>		<b>69,380,816</b>	<b>(203,426,868)</b>
	<b>Totali i Kapitalit</b>		<b>425,901,433</b>	<b>233,520,617</b>
<b>III</b>	<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>2,978,042,645</b>	<b>3,035,463,641</b>

Shënimet e paraqitura në faqen 7 deri në faqen 20 janë pjesë përberëse e këtyre pasqyrave financiare. Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Bordi Drejtues i Lengarica & Energy Shpk më 11 Nentor 2019, dhe janë nënshkruar nga:

Ylli Halili  
 Administrator



**Lengarica & Energy Shpk**  
**Pasqyra e performancës për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor**  
 (shumat në Lek)

	Shënime	2018	2017 (Riparaqitur)
▶ <b>Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit</b>	14	<b>231,902,615</b>	<b>90,604,065</b>
▶ <b>Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe punës në proces</b>		-	-
▶ <b>Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar</b>		-	-
▶ <b>Të ardhura të tjera të shfrytëzimit</b>	14	114,405	1,006,829
▶ <b>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</b>		-	-
1 <i>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</i>		-	-
2 <i>Të tjera shpenzime</i>		-	-
▶ <b>Shpenzime të personelit</b>	15	<b>(9,136,553)</b>	<b>(10,155,304)</b>
1 <i>Paga dhe shpërblime</i>		(8,263,064)	(9,184,442)
2 <i>Shpenzime të sigurimeveshoqërore/ shëndetsore</i>		(873,489)	(970,862)
▶ <b>Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale</b>		-	-
▶ <b>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</b>	6,7	<b>(102,542,082)</b>	<b>(99,741,050)</b>
▶ <b>Shpenzime të tjera shfrytëzimi</b>	16	<b>(156,612,106)</b>	<b>(96,208,233)</b>
▶ <b>Të ardhura të tjera financiare</b>	17	<b>186,079,006</b>	<b>42,492,329</b>
1 <i>Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (të ardhura të paraqitura veçmas nga njësitë ekonomike brenda grupit)</i>		-	-
2 <i>Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (të ardhura të paraqitura veçmas nga njësitë ekonomike brenda grupit)</i>		-	-
3 <i>Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera (të ardhura të paraqitura veçmas nga njësitë ekonomike brenda grupit)</i>	17	186,079,006	42,492,329
▶ <b>Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra</b>		-	-
▶ <b>Shpenzime financiare</b>		<b>(75,177,335)</b>	<b>(125,797,357)</b>
1 <i>Shpenzime interesi nga njësitë brenda grupit</i>		(75,177,335)	(125,797,357)
2 <i>Shpenzime të tjera financiare</i>		-	-
▶ <b>Pjesa e fitimit/(humbjes) nga pjesëmarrjet</b>		-	-
▶ <b>Fitimi/(humbja) para tatimit</b>		<b>74,627,950</b>	<b>(197,798,721)</b>
▶ <b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>	18	<b>(5,247,134)</b>	<b>(5,628,147)</b>
1 <i>Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin</i>		(481,699)	-
2 <i>Shpenzimi i tatimit fitimit të shtyrë</i>		(4,765,435)	(5,628,147)
3 <i>Pjesa e tatimit fitimit të pjesëmarrjeve</i>		-	-
▶ <b>Fitimi/(humbja) e vitit</b>		<b>69,380,816</b>	<b>(203,426,868)</b>
▶ <b>Fitimi/(humbja) për:</b>		-	-
1 <i>Pronarët e njësive ekonomike</i>		-	-
2 <i>Interesat jo-kontrolluese</i>		-	-

Shënimet në faqet 7 deri në 20 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



**Lengarica & Energy Shpk**  
**Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor**  
 (shumat në Lek)

	2018	2017 (Riparaqitur)
<b>► Fitim/(Humbja) e vitit</b>	<b>69,380,816</b>	<b>(203,426,868)</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:	-	-
Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja	-	-
Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	-	-
Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje	-	-
Të ardhura gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet	-	-
<b>► Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>	-	-
<b>► Totali i të ardhurave/(humbjeve) gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>69,380,816</b>	<b>(203,426,868)</b>
<b>► Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për:</b>		
<i>Pronarët e njësisë ekonomike</i>	-	-
<i>Interesat jo-kontrolluese</i>	-	-

Shënimet në faqet 7 deri në 20 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Lengarica & Energy Shpk**  
**Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare**  
(shumat në Lek)

	Shënime	2018	2017 (Riparaqitur)
<b>► Fluksi i Mjeteve Monetare nga aktiviteti i shfrytëzimit</b>			
<i>Fitim/(humbja) para tatimit</i>		74,627,950	(197,798,721)
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>			
<i>Shpenzimet jomonetare</i>		78,550,515	-
<i>Shpenzimet për tatimin mbi fitimin</i>		-	-
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>		102,542,082	99,741,050
<i>Humbje nga shitja e aktiveve</i>		265,196	-
<i>Të ardhurat nga interesi</i>		-	-
<i>Shpenzime interesi</i>		75,177,335	125,797,357
<i>Shpenzime të tjera financiare</i>		-	-
<b>Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:</b>			
<i>Shumat nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>		-	-
<i>Ndryshimet në kapitalin punues:</i>			
<i>Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera</i>		(138,854,957)	209,696,760
<i>Rënie/(rritje) në inventarë</i>		-	43,585
<i>Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme</i>		147,973,350	(156,435,941)
<i>Rritje/(rënie) në detyrimet e tjera</i>		161,492	(589,054)
<b>Mjete monetare neto përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit</b>		<b>340,442,963</b>	<b>80,455,036</b>
<b>► Fluksi i Mjeteve Monetare nga aktivitetet e investimit</b>			
<i>Para neto të përdorura për blerjen e filialeve</i>		-	-
<i>Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve</i>		-	-
<i>Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>		-	-
<i>Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>		(73,766)	(126,225)
<i>Pagesa për blerjen e aktive afatgjata jomateriale</i>		(30,579,888)	(65,750,917)
<i>Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera</i>		-	-
<i>Dividentë të arkëtuara</i>		-	-
<i>Hua të disbursuara</i>		-	-
<i>Arkëtime nga huatë</i>		-	-
<b>Mjete monetare neto përdorur në aktivitetet e investimit</b>		<b>(30,653,654)</b>	<b>(65,877,142)</b>
<b>► Fluksi i Mjeteve Monetare përdorur në aktivitetet e financimit</b>			
<i>Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar</i>		-	-
<i>Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral</i>		-	-
<i>Hua të arkëtuara</i>		-	(83,234,662)
<i>Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë</i>		-	-
<i>Riblerje e aksioneve të veta</i>		-	-
<i>Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral</i>		-	-
<i>Pagesa e huave</i>		(433,911,638)	-
<i>Pagesa për detyrimet e qirasë financiare</i>		-	-
<i>Interes i paguar</i>		-	-
<i>Dividendë të paguar</i>		-	-
<b>Mjete monetare neto nga aktivitetet e financimit</b>		<b>(433,911,638)</b>	<b>(83,234,662)</b>
<b>Rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalentë</b>		<b>(124,122,330)</b>	<b>(68,656,768)</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë më 1 janar 2018</b>	4	144,063,845	212,720,612
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë më 31 dhjetor 2018</b>	4	<b>19,941,515</b>	<b>144,063,845</b>

Shënimet në faqet 7 deri në 20 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Lengarica & Energy Shpk**
**Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor**

(shumat në Lek)

	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Humbja e vitit	Totali	Interesa Jo-Kontrollues	Totali
► <b>Pozicioni financiar më 1 janar 2017, sipas raportimit të mëparshëm</b>	<b>733,000,000</b>	-	-	-	-	-	<b>(281,598,582)</b>	-	<b>449,774,088</b>	-	<b>449,774,088</b>
Korigjimi i gabimit (referohuni shenimit 20)	-	-	-	-	-	-	(14,453,933)	-	(14,453,933)	-	(14,453,933)
<b>Pozicioni financiar i korigjuar me 1 janar 2017</b>	<b>733,000,000</b>	-	-	-	-	-	<b>(296,052,515)</b>	-	<b>436,947,485</b>	-	<b>436,947,485</b>
Humbja e vitit, sipas raportimit të mëparshëm	-	-	-	-	-	-	-	(188,945,317)	(188,945,317)	-	(188,945,317)
Korigjimi i gabimit (referohuni shenimit 20)	-	-	-	-	-	-	-	(14,481,551)	(14,481,551)	-	(14,481,551)
Humbja e vitit, e riparaqitur	-	-	-	-	-	-	-	(203,426,868)	(203,426,868)	-	(203,426,868)
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>	-	-	-	-	-	-	-	<b>(203,426,868)</b>	<b>(203,426,868)</b>	-	<b>(203,426,868)</b>
<b>Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin</b>	-	-	-	-	-	-	-	<b>(203,426,868)</b>	<b>(203,426,868)</b>	-	<b>(203,426,868)</b>
<b>Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike:</b>									-		-
Dividendë të paguar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
► <b>Pozicioni financiar më 1 janar 2018</b>	<b>733,000,000</b>	-	-	-	-	-	<b>(296,052,515)</b>	<b>(203,426,868)</b>	<b>233,520,617</b>	-	<b>233,520,617</b>
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	-	-	69,380,816	<b>69,380,816</b>		<b>69,380,816</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>	-	-	-	-	-	-	-	69,380,816	<b>69,380,816</b>		<b>69,380,816</b>
<b>Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin</b>	-	-	-	-	-	-	-	69,380,816	<b>69,380,816</b>	-	<b>69,380,816</b>
<b>Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike:</b>									-		-
Emetim kapitali (referojuni shënimit 12)	123,000,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Transferimi i humbjes së vitit të mëparshëm	-	-	-	-	-	-	(203,426,868)	203,426,868	-	-	-
<b>Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike</b>	<b>123,000,000</b>	-	-	-	-	-	<b>(203,426,868)</b>	<b>203,426,868</b>	-	-	-
► <b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018</b>	<b>856,000,000</b>	-	-	-	-	-	<b>(499,479,383)</b>	<b>69,380,816</b>	<b>425,901,433</b>	-	<b>425,901,433</b>

Shënimet shoqëruese në faqet 7 deri në 20 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## **1. Njësia raportuese**

Lengarica & Energy sh.p.k. (shoqëria) është një filial i zotëruar në masën 99.9% nga shoqëria Enso Hydro Energji sh.p.k. (me seli në Tiranë, Shqipëri), e cila nga ana e saj është filial i enso hydro GmbH (80%), shoqëria mëmë perfundimtare me seli në Austri. Aksionet e mbetura të shoqërisë janë në pronësi të Hasi Energji sh.p.k., shoqëri e cila është gjithashtu në pronësi të shoqërisë mëmë të Lengarica & Energy sh.p.k. Shoqëria është themeluar më 25 qershor 2008 me numër unik të identifikimit, NIPT, K83026602A dhe seli në Tiranë, Shqipëri. Veprimtaria kryesore e shoqërisë është ndërtimi, përdorimi i hidrocentraleve, prodhimi i energjisë elektrike dhe shitja e saj për klientët me shumicë dhe shpërndarësit.

Administratorët e Shoqërisë më 31.12.2018 janë Z. Ylli Halili dhe Z. Georg Schweighofer. Selia e shoqërisë është në Rr. "Jul Variboba", Vila Nr 10, Tiranë, Shqipëri. Numri i personelit më 31 dhjetor 2018 është 8 (31 dhjetor 2017: 8).

### **Kontrata konçesionare**

Në përputhje me kontratën e konçesionit të formës BOT (Ndërtim, Operim, Transferim) të datës 17 Prill 2008 (kontrata e konçesionit) ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Autoriteti kontraktor) dhe Hasi Energji sh.p.k. (Konçesionari) dhe bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 136, datë 14 Mars 2007 "Për përcaktimin e autoritetit kontraktor për ndërtimin me konçesion të hidrocentraleve Lengarica 1 dhe Lengarica 2", ndryshuar më 25 Prill 2009, duke i reduktuar hidrocentralet në një të vetëm. Hasi Energji sh. p. k., përmbushi kërkesën dhe krijoi Shoqërinë Konçesionare, Lengarica & Energy sh. p. k., me qëllimin e vetëm për të implementuar Kontratën e Konçesionit. Me themelimin e saj më 25 qershor 2008, Lengarica & Energy sh.p.k. transferoi automatikisht të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Konçesionit. Autoriteti Kontraktues i jep konçesionarit, me konçesion, të drejtën për të ndërtuar dhe operuar hidrocentralin "Lengarica", për një periudhë prej 35 vjetësh ("Periudha e Konçesionit"). Neni 3 i Kontratës së Konçesionit përcakton se Periudha e Konçesionit do të fillojë kur Kontrata e Konçesionit të hyjë në fuqi. Për më tepër, neni 16 i Kontratës së Konçesionit tregon se Kontrata e Konçesionit do të hyjë në fuqi pas miratimit të saj nga Këshilli i Ministrave në Republikën e Shqipërisë. Kontrata e konçesionit u miratua me Dekretin e Këshillit të Ministrave nr. 543 datë 1 maj 2008.

Autoriteti Kontraktues garanton blerjen e prodhimit të energjisë elektrike nga OSHEE sh.a. për 15 vitet e para të prodhimit. Marrëveshja e Blerjes së Energjisë Elektrike, e nënshkruar midis Konçesionarit dhe KESH Sh.a. më 29 Tetor 2015 që është zëvendësuar nga Marrëveshja e Blerjes së Energjisë Elektrike e nënshkruar midis Konçesionarit dhe OSHEE më 14 Shtator 2016, e cila parashikon detyrimin e blerësit (d.m.th OSHEE) të blejë 100% të energjisë elektrike të prodhuar me tarifën e përcaktuar të publikuar nga ERE. Data e fundit e furnizimit të garantuar të energjisë elektrike për Autoritetin Kontraktues është 15 Shtator 2030. Për afatin e mbetur të Kontratës së Konçesionit, maksimalisht 14 vjet, furnizimi me energji elektrike bëhet me çmime të parregulluara, të përcaktuara në bazë të kontratave të negociuara ndërmjet Shoqërisë Konçesionare dhe blerësve. Bazuar në ndryshimin e Kontratës së Konçesionit më 25 prill 2009 dhe 16 Korrik 2014, Shoqëria do të ndërtojë dhe shfrytëzojë vetëm një hidrocentral, atë të Lengaricës në komunën e Petranit të rrethit të Përmetit me një fuqi të instaluar prej 8,906 kW për një prodhim energjie në masën e 32,190,000 kW/h përgjatë 35 viteve të kontratës së konçesionit (në vend të 2 hidrocentraleve siç ishte planifikuar fillimisht në Kontratën e Konçesionit). Shoqëria ka vendosur në punë hidrocentralin në dhjetor të vitit 2015 dhe ka filluar prodhimin dhe shitjen e energjisë për KESH-in dhe në vitin 2016 për OSHEE-në.

Investimi total i miratuar është në shumën e 1,908,714 mijë Lekë. Tarifa e konçesionit që duhet paguar nga Shoqëria është në masën 2.1% të energjisë së prodhuar. Gjithashtu, Shoqëria është e detyruar të investojë 42% të vlerës totale të investimeve në makineri dhe pajisje në mënyrë që të transferojë hidrocentralin tek kontraktori në kushte të plota operative. Periudha e konçesionit është 35 vjet dhe data efektive e fillimit të saj është 1 maj 2008.

Pas përfundimit të Kontratës së Konçesionit, pasuritë e konçesioneve, përfshirë çdo ndërtesë ose fabrikë të ndërtuar nga Konçesionari, duhet të transferohen tek Autoriteti Kontraktues, pa asnjë pagesë dhe tarifë.

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

### **2.1 Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Detajet e politikave të rëndësishme kontabël të Shoqërisë janë përfshirë në Shënimin 3. Pasqyrat financiare të vitit që përfundon në 2017 janë riparaqitur dhe korigjimi i gabimeve përshkruhet në shënimin 20.

### **2.2 Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

### **2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare paraqiten në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë, monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilin shoqëria kryen aktivitetin e saj.

### **2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve.**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet përkatëse rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në mënyrë prospektive.

#### **2.4.1 Gjykime**

Informacioni në lidhje me gjykimet e bëra në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, përfshihet më poshtë:

- i) Marrëveshjet për koncesionin: përdorimi i qasjes të modelit të vetëm që është modeli i aktivitetit jo material. (Shënimi 7.i).
- ii) Parimi i vijimësisë: Drejtimi i përgatiti këto pasqyra financiare mbi bazën e parimit të vijimësisë. Në kryerjen e këtij gjykimi, drejtimi kreu një analizë të hollësishme duke marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat në dispozicion dhe pozicionin financiar të Shoqërisë, qëllimet aktuale, përmirësimin e pritshëm të përfitimit të operacioneve dhe aksesin në burimet financiare të grupit, në mënyrë që të konkludojë nëse Shoqëria mund të vazhdojë të funksionojë në përputhje me parimin e vijimësisë në të ardhmen e parashikueshme. Nën "të ardhmen e parashikueshme", drejtimi merr në konsideratë të gjitha informacionet e disponueshme për të ardhmen, e cila është të paktën, por nuk kufizohet në, dymbëdhjetë muaj nga përfundimi i periudhës së raportimit. Përfundimi nga analiza e mësipërme është se Shoqëria nuk përballet me ndonjë problem operimi dhe nuk parashikon ndonjë të tillë deri në fund të vitit 2019. Për më tepër, drejtimi i enso hydro GmbH ka shprehur angazhimin e tij për të vazhduar mbështetjen e operacioneve të Shoqërisë.

### **3. Politikat kontabël**

Politikat e mëposhtme kontabël janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në periudhat e paraqitura, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

#### **3.1 Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj, përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të momentit kur përcaktohet vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë që maten bazuar në koston historike në monedhë të huaj, përkthehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat nga konvertimi njihen përgjithësisht në fitim ose humbje.

Monedha Euro (e cila është monedha kryesore me të cilën operon shoqëria) u konvertua me kursin 123.42 (2017: 132.95) Lekë.

#### **3.2 Instrumentet financiarë**

Instrumentet financiarë joderivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentet financiarë joderivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumentat që nuk maten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë.

Pas njohjes fillestare instrumentet financiarë joderivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur në thelb kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, e cila është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiarë çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

##### *Mjetet monetare dhe ekuivalentet e mjeteve monetare*

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e mjeteve monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtër me bankat, të cilat fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe në vijim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozitat pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit të tyre.

##### *Llogaritë e arkëtueshme dhe të arkëtueshme të tjera*

Llogaritë e arkëtueshme dhe të arkëtueshme të tjera fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi. Një provizion për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme regjistrohet kur ekzistojnë prova objektive që shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumatat në afatet fillestare të përcaktuara. Vështirësi të konsiderueshme financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose të riorganizohet financiarisht konsiderohen tregues që llogaria e arkëtueshme është zhvlerësuar. Shuma e provizionit është diferenca midis vlerës kontabël të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare të vlerësuar, të aktualizuara me normën fillestare efektive të interesit.

##### *Llogaritë e pagueshme dhe të pagueshme të tjera*

Llogaritë e pagueshme dhe të pagueshme të tjera fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

### **3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)**

#### **3.2 Instrumentet financiarë (vazhdim)**

##### *Huamarrjet*

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerë të drejtë minus kostot e transaksionit ndërsa më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### *Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse*

Titujt e pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse njihen fillimisht me kosto, dhe më pas maten me kosto minus humbjet nga zhvlerësimi.

##### *Të tjera*

Instrumente të tjerë financiarë joderivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

##### *Vlera e drejtë*

Vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar, huave, minus çdo zhvlerësim, supozohen të jenë të përafërta me vlerat e tyre kontabël.

#### **3.3 Aktive afatgjata materiale dhe jo-materiale**

##### **3.3.1 Aktivët afatgjata materiale**

###### **(i) Njohja dhe matja**

Aktivët afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar, nëse ka. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit.

Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte (nqs përfshihet), çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të kryera gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtime në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur zbatohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga nxjerrjet jashtë përdorimit të një zëri përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur të aktivit, dhe njihen neto në “të ardhura të tjera” në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

###### **(ii) Kostot e mëpasshme**

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

###### **(iii) Amortizimi**

Amortizimi ngarkohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën rënëse për të gjitha aktivët afatgjata materiale, mbi jetën e dobishme të vlerësuar të secilës pjesë të një aktivit afatgjatë material duke nisur nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Jetëgjatësia e dobishme e vlerësuar për periudhën aktuale dhe metodat përkatëse të amortizimit janë si më poshtë:

Kategoritë	Metoda e amortizimit	Norma amortizimit
Pajisje IT	Vlera e mbetur	25%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Te tjera instalime dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

### **3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)**

#### **3.3.2 Aktivet afatgjata jo-materiale**

##### **Marreveshje koncesionare**

Shoqëria njih një aktiv jomaterial që rrjedh nga një marrëveshje koncesionare, kur ajo ka të drejtë të tarifojë përdorimin e infrastrukturës së koncesionit. Një aktiv jomaterial i marrë si konsideratë për ofrimin e shërbimeve të ndërtimit ose të përmirësimit në një marrëveshje koncesionare të shërbimit, matet me vlerën e drejtë në momentin e njohjes fillestare, duke ju referuar vlerës së drejtë të shërbimeve të ofruara. Pas njohjes fillestare, aktivi jo-material matet me kosto, e cila përfshin kostot e kapitalizuara të huamarrjes, duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Jeta e dobishme e vlerësuar e një aktivi jo-material në një marrëveshje koncesionare është periudha nga kur Shoqëria është në gjendje të tarifojë publikun për përdorimin e infrastrukturës deri në fund të periudhës së koncesionit.

#### **3.4 Zhvlerësimi**

##### **(i) Aktivet financiare**

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut të kreditit. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### **(ii) Aktivet jo-financiare**

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Shuma e rikuperueshme e një aktivi ose njësie gjeneruese mjetesh monetare (CGU) është më e madhja midis vlerës së saj në përdorim dhe vlerës së drejtë të saj minus kostot e shitjes. Për vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e parashikuara monetare skontohe duke përdorur një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën kohore të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin. Për qëllime të testimit të zhvlerësimit, aktivet grupohen së bashku në grupin më të vogël të aktiveve që gjenerojnë hyrje të mjeteve monetare nga përdorimi i vazhdueshëm, të cilat janë të pavarura nga hyrjet në mjete monetare të aktiveve ose grupeve të tjera të aktiveve ("CGU")

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi apo e "CGU" së tij tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Humbjet nga zhvlerësimi në lidhje me "CGU" janë shpërndarë për të zvogëluar vlerën kontabël të aktiveve në njësi (grup njësis) në baza proporcionale. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë indikacion se humbja është zvogëluar ose nuk ekziston më. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet vetëm në atë masë që vlera kontabël neto e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël neto që do të ishte përcaktuar, duke zbritur amortizimin dhe zhvlerësimin, nëse nuk do të ishte njohur humbja nga zhvlerësimi.



### **3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)**

#### **3.5 Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe ka një mundësi që të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

#### **3.6 Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat në lidhje me ndërtimin ose shërbimet e përmirësimit në bazë të një marrëveshje koncesionare për shërbime njihen me kalimin e kohës, në përputhje me politikën kontabël të Shoqërisë për njohjen e të ardhurave nga kontratat e ndërtimit. Të ardhurat nga veprimtaria ose shërbimi njihen në periudhën në të cilën shërbimet ofrohen nga Shoqëria. Nëse marrëveshja e koncesionit të shërbimit përmban më shumë se një kusht performance, atëherë vlerësimi i marrë shpërndahet duke iu referuar çmimeve specifike relative të shitjes së shërbimeve të ofruara.

HEC-i është vënë në punë në dhjetor 2015 dhe drejtimi arriti në përfundimin se të ardhurat e pritura nga projekti që nga 2015 nuk çuan në një marzh pozitiv nga faza e ndërtimit të hidrocentralit. Supozimi i drejtimit u bazua në faktin e një kostoje specifike relativisht të lartë.

Drejtimi parashikoi gjatë periudhës së koncesionit operacional asnjë ose pak rrezik për të marrë të ardhura të mjaftueshme nga furnizimi i energjisë elektrike bazuar në faktin se rreziku i prodhimit supozohet të jetë i ulët sipas studimeve hidrologjike të besueshme të ekspertëve të pavarur ndërkombëtarë. Për më tepër, marrëveshja për blerjen e energjisë garanton shitjen e sasisë së plotë të energjisë elektrike të prodhuar nga Shoqëria tek Autoriteti Kontraktues gjatë 15 viteve të para dhe parashikimet tregojnë një kërkesë në rritje të energjisë për periudhën e mbetur, duke supozuar rrezik të ulët për shitjen e energjisë në treg. Në këto rrethana, drejtimi konsideroi se çdo e ardhur duhet të jetë të paktën sa kostot e prodhimit pa marzh fitimi dhe konsideroi të përshtatshme që të mos njihete në këto pasqyra financiare shumat përkatëse.

#### **3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura nga interesi për fondet e investuara, huatë tek njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse dhe fitime nga kursi i këmbimit. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet, humbjet nga kursi i këmbimit, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

#### **3.8 Tatimi mbi fitimin**

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen drejtëpërsëdrejti në kapital ose të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

##### *Tatimi aktual*

Tatimi aktual është tatimi i pritshëm për t'u paguar ose i arkëtueshëm mbi fitimin e tatueshëm ose humbjen e vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës ose në datën e raportimit, dhe të gjitha ndryshimet e detyrimeve të tatimit për vitet e kaluara.

##### *Tatimi i shtyrë*

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime fiskale.

Aktivitet për tatime të shtyra njihen për humbje tatimore të papërdorur dhe diferencat e zbritshme të përkohshme në masën që është e mundur që fitimet e tatueshme të ardhshme të jenë në dispozicion për tu përdorur kundrejt tyre.

### **3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)**

#### **3.8 Tatimi mbi fitimin (vazhdim)**

Fitimet e ardhshme të tatueshme përcaktohen bazuar në anulimin e diferencave të përkohshme tatimore. Nëse diferencat e përkohshme tatimore nuk mjaftojnë për të njohur të plotë një aktiv tatimor të shtyrë, atëherë konsiderohen fitimet e ardhshme të tatueshme, të rregulluara për anulimet e diferencave të përkohshme ekzistuese, bazuar në planin e biznesit. Aktivitet tatimore të shtyra rishikohen çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri në masën në të cilën nuk është më e mundur të realizohet përfitim tatimor; këto zvogëlime anulohen kur rriten mundësitë për fitime të ardhshme të tatueshme.

Aktivitet e panjohura tatimore të shtyra rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen deri në masën që është bërë e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme kundrejt të cilave mund të përdoren të jenë të mundshme.

Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato kthehen, duke përdorur normat tatimore të miratuara ose që hyjnë në zbatim në mënyrë substanciale në datën e raportimit.

Matja e tatimit të shtyrë pasqyron pasojat tatimore që do të pasojnë nga mënyra në të cilën shoqëria pret të rimarrë ose të shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të saj në datën e raportimit.

Aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompesohen vetëm nëse disa kritere të caktuara përmbushen.

Legjislacioni tatimor shqiptar, i miratuar ose në zbatim në mënyrë substanciale në datën e raportimit, është subjekt i interpretimeve të ndryshme në lidhje me aplikimin mbi transaksionet dhe aktivitetet e shoqërisë. Rrjedhimisht, trajtimet tatimore të vendosura nga menaxhimi dhe dokumentacioni zyrtar mbështetës mund të kundërshtohen nga autoritetet tatimore. Periudhat fiskale mbeten të hapura për t'u audituar nga autoritetet tatimore për tre vite kalendarike para vitit kur është marrë vendimi për rishikim. Në rrethana të caktuara, auditimet mund të mbulojnë periudha më të gjata.

Detyrimet regjistrohen për pozicionet e tatimit mbi të ardhurat, të përcaktuara nga menaxhimi, të cilat ka më shumë gjasa që të mos rezultojnë në vendosjen e taksave shtesë nëse vendimet do të kundërshtoheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore që janë miratuar ose janë në fuqi në mënyrë substanciale deri në fund të periudhës raportuese, dhe çdo çështje gjyqësore të njohur ose vendime të tjera për çështje të tilla. Detyrimet për gjokat, interesat dhe tatime të tjera mbi fitimin njihen bazuar në vlerësimin më të mirë të drejtimit për shpenzimet e nevojshme për të shlyer detyrimet në fund të periudhës raportuese.

#### **3.9 Përfitimet e punonjësve**

##### *Përfitimet afatshkurtëra të punonjësve*

Përfitimet afatshkurtëra të punonjësve njihen si shpenzim kur ofrohet shërbimi i lidhur me to. Një detyrim njihet për shumën që pritet të paguhet nëse shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i një shërbimi të kaluar të ofruar nga punonjësi dhe detyrimi mund të matet në mënyrë të besueshme.

##### *Pensionet e detyrueshme*

Shoqëria, gjatë rrjedhës normale të biznesit, bën pagesa për llogari të vet dhe punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet e detyrueshme sipas legjislacionit lokal. Shpenzimet e bëra në emër të Shoqërisë njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

## 4. Aktive monetare dhe ekuivalente e tyre

	<b>2018</b>	<b>2017</b>
Banka në Lek	2,396,520	620,620
Banka në Euro	17,383,685	143,388,842
Arka	161,311	54,383
<b>Totali</b>	<b>19,941,516</b>	<b>144,063,845</b>

Mjetet monetare në bankë në Euro më 31 Dhjetor 2018 dhe më 31 Dhjetor 2017 janë në Raiffeisen Bank Albania, grupi i së cilës (Raiffeisen International AG) është klasifikuar A-2 nga S&P dhe IntesaSanPaolo Bank Albania sha grupi i së cilës (IntesaSanPaolo Bank) është klasifikuar A-2 nga S&P.

## 5. Llogari të arketueshme dhe të tjera të arketueshme

	<b>2018</b>	<b>2017</b>
TVSH e arkëtueshme	70,594,777	107,651,235
Shpenzime të shtyra	11,957,610	15,275,815
Të arkëtueshme nga palë të treta	-	10,111,987
Të arketueshme të tjera	208,800,056	19,318,448
Parapagim tatim fitimi	-	140,000
<b>Totali</b>	<b>291,352,443</b>	<b>152,497,485</b>

TVSH-ja e arkëtueshme vjen nga ndërtimi i aktivitet koncesionar pasi shërbimet e ofruara nga furnitorët e njësisë ekonomike janë subjekt i TVSH-së. Rikuperimi i TVSH-së kompesohet ndaj detyrimeve të ardhshme të TVSH-së që vijnë nga shitja e energjisë. Shpenzimet e shtyra kryesisht kanë të bëjnë me parapagimin për sigurimin operacional te hidrocentralit.

Të arkëtueshme të tjera përbëhen nga kërkesat kontraktuale në lidhje me ndërtimin e HEC-it në vlerë prej 188,612,595 lekë dhe të ardhura të shtyra për shitje të energjisë elektrike prej 20,187,461 lekë (2017: 19,318,448 lekë).

**Lengarica & Energy sh.p.k**

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018**

(shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

**6. Aktivët afatgjata materiale**

	Mjete transporti	Mobilje dhe orendi	Pajisje informatike dhe të tjera	Permiresim ambjenti	Paisje zyre dhe të tjera	Totali
<b>Kosto</b>						
Më 1 Janar 2017	1,967,420	580,947	619,875	146,896	1,213,386	4,528,524
Shtesa	-	-	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2017	1,967,420	580,947	619,875	146,896	1,213,386	4,528,524
Shtesa	-	-	73,766	-	-	73,766
Pakesime	(1,120,160)	-	-	-	-	(1,120,160)
<b>Më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>847,260</b>	<b>580,947</b>	<b>693,641</b>	<b>146,896</b>	<b>1,213,386</b>	<b>3,482,130</b>
<b>Amortizimi</b>						
Më 1 Janar 2017	(1,187,010)	(381,977)	(369,027)	(25,404)	(561,785)	(2,525,203)
Shpenzime	(156,084)	(39,792)	(44,430)	(6,076)	(125,697)	(372,079)
Më 31 Dhjetor 2017	(1,343,094)	(421,769)	(413,457)	(31,480)	(687,482)	(2,897,282)
Shtesa	(109,265)	(31,836)	(58,098)	(5,772)	(105,180)	(310,151)
Pakesime	854,963	-	-	-	-	854,963
<b>Më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>(597,396)</b>	<b>(453,605)</b>	<b>(471,555)</b>	<b>(37,252)</b>	<b>(792,662)</b>	<b>(2,352,470)</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>						
Më 31 Dhjetor 2017	624,326	159,178	206,418	115,416	525,904	1,631,242
Më 31 Dhjetor 2018	249,864	127,342	222,086	109,644	420,724	1,129,660

**7. Aktivët afatgjata jo-materiale**

	Aktivi koncesionar
<b>Kosto</b>	
Më 1 Janar 2017	2,770,889,123
Shtesa	65,750,917
Më 31 Dhjetor 2017	2,836,640,040
Shtesa	30,579,888
<b>Më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>2,867,219,928</b>
<b>Amortizimi</b>	
Më 1 Janar 2017	-
Shtesa	(99,368,971)
Më 31 Dhjetor 2017	(99,368,971)
Shtesa	(102,231,931)
<b>Më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>(201,600,902)</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>	
Më 31 Dhjetor 2017	2,737,271,069
<b>Më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>2,665,619,026</b>

**7. Aktivet afatgjata jo-materiale (vazhdim)***(i) Marreveshja koncesionare e shërbimit*

Siç shpjegohet në shënimin 1, Shoqëria hyri në një marrëveshje koncesionare shërbimi me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë dhe vlerësoi zbatueshmërinë e SKK 13 dhe KIRFN 12. Drejtimi arriti në përfundimin se detyrimi i ndërmarrë nga Shoqëria ka natyrë publike dhe një "Kontratë koncesioni e llojit Ndërtimi - Operimi - Transferimi (BOT)" është zakonisht objekt i KIRFN 12. Për më tepër, marrëveshja koncesionare konsiderohej të ishte objekt i KIRFN 12 pasi ekzistojnë të dy kushtet e mëposhtme:

- (a) Furnizimi me energji nën marrëveshjen e shërbimit sigurohet nga një shoqëri e cila i nënshtrohet një organi të pavarur rregullator (d.m.th. ERE) me detyrime për të rregulluar aksesin në tregjet e shërbimeve që veprojnë në interes publik, duke konkluduar se marrëveshja kontrollohet në thelb nga dhënësi i koncesionit. Drejtimi arriti në përfundimin se bazuar në tërësinë e të gjitha fakteve dhe rrethanave dhënësi i koncesionit po ushtron në mënyrë thelbësore kontroll gjatë periudhave të marrëveshjes së koncesionit të rregulluara dhe të parregulluara pasi vetëm disa aktivitete të caktuara (p.sh. klienti, çmimi) nuk mund të drejtohen nga dhënësi i koncesionit gjatë periudhës të parregulluar. Për më tepër, drejtimi konsideroi vlerësimin e tij për marrëveshjen në tërësi dhe konsideroi se çmimet e tarifuarra janë të rregulluara për pjesën mbizotëruese të afatit të koncesionit
- (b) Dhënësi i koncesionit kontrollon, përmes pronësisë, të drejtës përfituese, ose në forma të tjera, çdo interes të mbetur në infrastrukturë në fund të afatit të marrëveshjes. Në rast të përfundimit të Kontratës së Koncesionit, pasuritë e koncesioneve, përfshirë çdo ndërtesë ose impiant të ndërtuar nga Koncesionari, duhet të transferohen tek Autoriteti Kontraktues, pa asnjë pagesë dhe tarifë.

Drejtimi konkludoi gjithashtu se Koncesionari mbart rrezikun e kërkesës, sepse të ardhurat dhe kthimi financiar varen plotësisht nga sasia e energjisë elektrike të prodhuar, pa të ardhura minimale të garantuara. Prandaj, drejtimi e pa të arsyeshme të njohë një aktiv jo-material që rrjedh nga marrëveshja koncesionare e shërbimit pasi ka të drejtë të tarifojë për përdorimin e infrastrukturës së koncesionit.

*(ii) Kolaterali*

Artikujt e zërave të aktiveve jo-materiale me një vlerë kontabël prej 12,300,000 EUR janë vendosur si kolateral për kredinë me IntesaSanPaolo Bank më 31 Dhjetor 2018 (referojuni shënimin 12).

*(iii) Testi i zhvleresimit*

Drejtimi testoi për zhvlerësim aktivet e tij jo-materiale në 31 Dhjetor 2018. Për qëllimin e testit të zhvlerësimit, drejtimi i konsideroi aktivet e tij si një CGU.

Drejtimi beson se vlera kontabël do të mbulohet nga flukset e ardhshme të parave nga aktiviteti operativ i Shoqërisë dhe shuma e rikuperueshme e CGU u vlerësua bazuar në vlerën e saj në përdorim.

Supozimet kryesore të përdorura në vlerësimin e shumës së rikuperueshme i nënshtrohen vlerësimeve të rëndësishme të Drejtimit dhe vlera në përdorim e CGU u përcaktua të ishte më e lartë se vlera e saj kontabël.

**8. Llogari të pagueshme dhe te tjera te pagueshme**

	<u>2018</u>	<u>2017</u>
Llogari të pagueshme ndaj palëve të treta	58,473,315	18,177,586
Llogati të pagueshme ndaj palëve të lidhura	50,964,108	26,053,413
<b>Totali</b>	<b><u>109,437,423</u></b>	<b><u>44,230,999</u></b>

Llogaritë e pagueshme konsistojnë kryesisht në shërbimet e konsulencave ligjore dhe konsulencave të tjera të papaguara në datën e raportimit.

**Lengarica & Energy sh.p.k****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018***(shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)***9. Detyrime ndaj punonjesve, taksa dhe detyrime tatimore**

	<b>2018</b>	<b>2017</b>
Detyrime per pagat dhe kompensime	-	317,922
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	142,567	113,994
Detyrime per tatimin mbi te ardhurat personale	94,562	26,999
Detyrime për tatimin në burim	55,457	13,878
Tatim fitim i pagueshëm	341,699	-
<b>Totali</b>	<b>634,285</b>	<b>472,793</b>

**10. Detyrime te tjera**

Shuma prej Lek 74,052,000 në 31 Dhjetor 2018, e përfshirë në detyrime të tjera lidhet me një kërkesë kontraktuale në lidhje me ndërtimin e HEC-it.

**11. Provizione**

Shoqëria njohu një provizion prej Lek 78,550,515 më 31 Dhjetor 2018 në lidhje me një kërkesë kontraktuale që lidhet me ndërtimin e HEC-it.

**12. Titujt e huamarrjes**

<i>Shumat në '000</i>	<b>31 Dhjetor 2018</b>			<b>31 Dhjetor 2017</b>		
	<b>Shuma e huasë</b>	<b>Interesa të përlllogaritur</b>	<b>Shuma totale</b>	<b>Shuma e huasë</b>	<b>Interesa të përlllogaritur</b>	<b>Shuma totale</b>
IntesaSanPaolo						
Bank	1,387,691	-	<b>1,387,691</b>	1,635,285	14,786	<b>1,650,071</b>
Enso hydro Energji shpk	681,666	202,595	<b>884,261</b>	901,021	193,416	<b>1,094,437</b>
<b>Totali</b>	<b>2,069,357</b>	<b>202,595</b>	<b>2,271,952</b>	<b>2,536,306</b>	<b>208,202</b>	<b>2,744,508</b>

Gjatë vitit 2017, Shoqëria pagoi plotësisht pjesën e mbetur të huasë ndaj Green For Growth Fund (GGF) dhe Southeast Europe S.A, SICAV-SIF dhe OesterreichischeEntwicklungsbank AG (OeEB).

Pagesa e huasë ndaj GGF u krye nëpërmjet marrjes së një huaje prej 12,300,000 EUR (1,635,285,000 Lekë) nga IntesaSanPaolo Bank Albania, me një normë interesi prej 3.5% për t'u shlyer plotësisht deri në vitin 2032 me këstin e parë të pagueshëm në 1 Janar 2018. Huaja ndaj IntesaSanPaolo Bank Albania është siguruar nëpërmjet kuotave të shoqërisë, aktiveve jomateriale, llogarive rrjedhëse në Intesa SanPaolo Bank dhe llogarive të arkëtueshme me vlerë kontabël prej 12,300,000 EUR.

Huatë nga aksioneri Enso Hydro Energji sh.p.k janë përdorur për investimet e kryera në aktivet e koncesionit. Norma e interesit e aplikuar nga Enso Hydro Energjish.p.k. gjatë vitit 2018 ishte 3% (2017: 3.25%). Gjatë vitit 2018, një vlerë prej 123,000 mijë lekësh u konvertua në kapital.

Shpenzimet e llogaritura përbëhen nga interesi i përlllogaritur i huave prej 202,594,926 Lek (2017: 193,416,552 Lek) dhe të ardhurat e shtyra prej 441,438 Lek (2017: 423,187 Lek).

**Lengarica & Energy sh.p.k****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018***(shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)***13. Kapitali i paguar**

Kapitali i paguar i shoqërisë në 31 Dhjetor 2018 është 856,000,000 Lekë (2017: 733,000,000 Lekë).  
Lëvizjet në pasqyrën e kapitalit deri në datën e raportimit janë si më poshtë:

	Enso Hydro Energji shpk % e pjesëmarrjes	Hasi Energji shpk % e pjesëmarrjes	Vlera nominale në Lek
Më 1 Janar 2018	<b>732,980,000</b>	<b>20,000</b>	<b>733,000,000</b>
<i>Hua konvertuar në kapital</i>	<i>123,000,000</i>	-	<i>123,000,000</i>
<b>Më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>855,980,000</b>	<b>20,000</b>	<b>856,000,000</b>
<b>Në %</b>	<b>99,99%</b>	<b>0,00%</b>	<b>100%</b>

**14. Të ardhurat**

	2018	2017
Shitje energjie	231,902,615	90,604,065
Te tjera	114,405	1,006,829
<b>Totali</b>	<b>232,017,020</b>	<b>91,610,894</b>

**15. Shpenzime të personelit**

	2018	2017
Pagat dhe shperblimet	8,263,064	9,184,442
Shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	873,489	970,862
<b>Totali</b>	<b>9,136,553</b>	<b>10,155,304</b>

**16. Shpenzime të tjera shfrytëzimi**

	2018	2017
Shpenzime administrative	690,305	55,106,973
Shpenzime të projektit Lengarica	24,418,700	12,472,260
Shpenzime sigurimi	9,836,903	10,345,574
Konsulencë ligjore	11,167,263	6,400,063
Shpenzime për auditim dhe konsulencë tatimore	6,768,748	2,023,329
Licensa dhe koncesione	5,349,520	2,008,162
Shpenzime mirëmbajtjeje	8,091,404	1,559,256
Provizione	78,550,515	-
Të tjera	6,625,305	1,461,339
Qira zyre	674,851	977,345
Shpenzime për makina dhe qira financiare	1,278,797	897,262
Shpenzime për tokë me qira	-	636,928
Shpenzime telefonie	234,939	528,405
Materiale zyre	217,953	459,987
Taksa të ndryshme nga tatim fitimi	369,483	357,293
Shpenzime përfaqesimi	233,712	273,910
Shpenzime interneti dhe komunikime elektronike të tjera	172,500	210,000
Shërbime përkthimi	-	186,700
Shpenzime udhëtimi	799,185	157,818
Shpenzime postare	19,650	145,629
Konsulenca të tjera	1,112,373	-
<b>Totali</b>	<b>156,612,106</b>	<b>96,208,233</b>

**Lengarica & Energy sh.p.k****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018***(shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)***17. Të ardhura financiare të tjera**

	<u>2018</u>	<u>2017</u>
Fitime nga kursi i këmbimit	198,876,114	88,659,548
Humbje nga kursi i këmbimit	(12,797,108)	(46,167,219)
<b>Totali</b>	<b><u>186,079,006</u></b>	<b><u>42,492,329</u></b>

**18. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 është 15% (2017 :15%).

	<u>2018</u>	<u>2017</u>
Fitimi/(humbja) e vitit	74,627,951	(197,798,720)
Amortizimi për qëllime tatimore i aktiveve jomateriale të koncesionit	(134,001,495)	(136,889,952)
Amortizimi kontabël i pazbritshëm i aktiveve jomateriale të koncesionit	102,231,931	99,368,971
Shpenzime të tjera të pazbritshme	100,604,901	135,139,074
<b>Fitimi/(humbja) e tatueshme për vitin</b>	<b><u>143,463,288</u></b>	<b><u>(100,180,628)</u></b>
<b>Përdorimi i humbjeve tatimore të mbartura</b>	<b><u>(140,251,960)</u></b>	<b><u>(50,752,062)</u></b>
<b>Fitimi i tatueshëm</b>	<b><u>3,211,328</u></b>	
<b>Shpenzimi i tatim fitimit</b>	<b><u>481,699</u></b>	

Humbjet tatimore të mbartura në 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 janë të detajuara si më poshtë:

	<u>2018</u>	<u>2017</u>
Humbja Tatimore 2014	-	(10,680,730)
Humbja Tatimore 2015	(40,071,332)	(40,071,332)
Humbja Tatimore 2016	-	-
Humbja Tatimore 2017	(100,180,628)	(100,180,628)
Humbja Tatimore 2018	143,463,288	-
<b>Fitim/(humbje) e tatueshme e mbartur</b>	<b><u>3,211,328</u></b>	<b><u>(50,752,062)</u></b>

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por fitimet apo humbjet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore. Detyrimi i njohur i tatimit të shtyrë në datën 31 Dhjetor 2018 është Lek 17,073,404 Lek (2017: Lek 12,307,969) dhe lidhet me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktitit jomaterial për qëllime raportimi dhe bazës së tij tatimore.

**19. Palë të lidhura**

Gjatë kryerjes së veprimtarisë normale të biznesit, shoqëria kryen transaksione me palet e lidhura. Shoqëria kryen transaksione me shoqërinë mëmë të saj dhe me filialet e saj. Balancat dhe transaksionet e shoqërisë me palët e lidhura në datën e bilancit janë si më poshtë:

	<b>Marrëdhënia</b>	<b>31 Dhjetor 2018</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>
<b>Detyrimet</b>			
<b><u>Hua të pagueshme</u></b>			
Enso Hydro Energji sh.p.k.	Shoqëria mëmë	681,665,993	901,020,822
Enso Hydro Energji sh.p.k. (e përllogaritur)	Shoqëria mëmë	202,594,926	193,416,552
<b><u>LLogari të pagueshme</u></b>			
Enso Hydro Energji sh.p.k.	Shoqëria mëmë	5,299,694	-
enso hydro GmbH	Shoqëria mëmë përfundimtare	45,664,414	26,053,413
<b>Pasqyra e performancës</b>			
<b><u>Shpenzime rrjedhëse</u></b>			
enso hydro GmbH	Shoqëria mëmë përfundimtare	21,024,586	7,714,535
Enso Hydro Energji sh.p.k.	Shoqëria mëmë	-	3,269,153
<b><u>Shpenzime interesi</u></b>			
Enso Hydro Energji sh.p.k.	Shoqëria mëmë	23,042,682	28,832,811



**20. Korigjimi gabimeve**

Gjatë vitit 2018, Shoqëria zbuloi se parashikimi i afatit efektiv të koncesionit duhet të fillonte në 2008 në vend të 2015 dhe jeta e dobishme e aktivitetit të koncesionit të shërbimit ishte konsideruar gabimisht 35 vjet dhe jo 29 vjet, gjatë përgatitjes së pasqyrave të saj financiare në 2016 dhe 2017. Për më tepër, drejtimi arriti në përfundimin se bazuar në të gjitha faktet dhe rrethanat, aplikimi i modelit të vetëm jo-material dhe jo i modelit të përzier është i përshtatshëm. Si pasojë, shpenzimet e zhvlerësimit janë mbivlerësuar, zhvlerësimi dhe amortizimi janë nënvlerësuar dhe aktivitetet përkatëse afatgjata janë mbivlerësuar. Gabimet janë korrigjuar duke riparuar secilin prej zërave të pasqyrave financiare të prekura për periudhat e mëparshme. Tabelat e mëposhtme përmbledhin ndikimet në pasqyrat financiare:

## (i) Pasqyra e Pozicionit Financiar

31 dhjetor 2017

në Lek

	Ndikimi i korigjimit të gabimit		
	Raportimi fillestar	Rregullime	Riparaqitur
Aktivitet jo-materiale (Shënimi 7)	1,678,590,981	1,058,680,088	2,737,271,069
Të arkëtueshme nga koncesioni	1,092,721,834	(1,092,721,834)	-
<b>Totali</b>	<b>2,771,312,815</b>	<b>(34,041,746)</b>	<b>2,737,271,069</b>
Detyrimi i tatimit të Shtyrë (Shënimi 18)	17,414,231	(5,106,262)	12,307,969
Humbje të akumuluar	(470,543,899)	(28,935,484)	(499,479,383)
<b>Totali</b>	<b>453,129,668</b>	<b>(34,041,746)</b>	<b>487,171,414</b>

## (ii) Pasqyra e performancës dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2017

në Lek

	Ndikimi i korigjimit të gabimit		
	Raportimi fillestar	Rregullime	Rideklarimi
Zhvlerësimi	(82,331,852)	82,331,852	-
Zhvlerësimi dhe amortizimi (shënimet 6 dhe 7)	(372,079)	(99,368,971)	(99,741,050)
Tatim fitimi i shtyrë (Shënimi 18)	(8,183,715)	2,555,568	(5,628,147)
<b>Totali</b>	<b>(90,887,646)</b>	<b>(14,481,551)</b>	<b>(105,369,197)</b>
Humbja e vitit	(188,945,317)	(14,481,551)	(203,426,868)
<b>Totali</b>	<b>(188,945,317)</b>	<b>(14,481,551)</b>	<b>(203,426,868)</b>

**21. Ngjarje pas periudhës së raportimit**

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që kërkojnë rregullime apo shënime të tjera shpjeguese në këto pasqyra financiare.